




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-9835/24 datë:19.04.2024



Npi – 01/142 datë: 29.04.2024

Bazuar në nenin 40.2 pika (d) si dhe neni 58 pika (j) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 45.4 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, si dhe mbi bazën e prezentimit të Raportit tre mujor financiar për vitin 2024 nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 29.04.2024, aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT FINANCIAR PËR TRE MUJORIN E PARË
JANAR-MARS 2024**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -IV- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 29.04.2024, me shumicën e votave miratoi, Raportin Financiar të Komunës së Shtimes për tre mujorin e parë Janar-Mars 2024.

II

Kuvendi i Komunës ka marrë për bazë edhe rekomandimin nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi